



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

.Dh.Sh.II.nr.1290/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr.“Armend Daci” nr.1, kundër debitorit “Isufi” SH.P.K., me seli në Dabidol, Komuna e Rahovecit, me bazë juridike përmbarimore, pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1420/2022 të datës 29.05.2023, me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitorit “Isufi” SH.P.K., me seli në Dabidol, Komuna e Rahovecit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1420/2022 i datës 29.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1420/2022 të datës 29.05.2023, në pikën I të dispozitivit ka Refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit “Isufi” SH.P.K., me numër të biznesit 71259218, të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.359/2021, të lejuar me datë 02.04.2021, nga Përmbaruesi Privat Mehdi Reshani. Në pikën II të dispozitivit urdhrin përmbarimor P.nr.59/2021, të lejuar me datë 02.04.2021, nga përmbaruesi privat Mehdi Reshani, e ka Lënë në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje ose aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që debitori të lirohet nga pagesa për shkak të parashkrimit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr.“Armend Daci” nr.1, me datë 02.04.2021 ka paraqitur propozim për përmbarrim kundër debitorit “Isufi” SH.P.K., me seli në Dabidol, Komuna e Rahovecit, në bazë të dokumentit përmbarrues - aktvendimit Nr.4912 të datës 10.12.2019, i formës së prerë nga data 26.08.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 11.09.2020.

Përmbarruesi privat Mehdi S. Reshani, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.359/2021 të datës 02.04.2021, ka lejuar përmbarrimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarrues, duke vlerësuar se dokumenti përmbarrues i plotëson kushtet për përmbarrim.

Kundër këtij urdhri përmbarrimor, debitori me datë 20.04.2021 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e të njëjtit, se propozimi i kreditorit është i mangët. Ka shtuar se nuk është e vërtetë se debitori ka mbetur borxh apo pa paguar gjrobat dhe se nuk ka kryer asnjë aktivitet të jashtëligjshëm. Tutje, ka theksuar se kërkesa e kreditorit është përfshi në parashkrim sipas dispozitave të LMD-së. Për këto arsye, ka propozuar që të aprovohet prapësimi ashtu që urdhri përmbarrimor të shfuqizohet.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 27.04.2021, duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se i njëjti është i pabazuar dhe nuk përmban arsye në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të debitorit për parashkrim të borxhit, ka theksuar se nuk qëndrojnë ngase nuk kanë kaluar 10 vite siç parashihet me nenin 379 të LMD-së. Kreditori ka shtuar se urdhri për përmbarrim është i drejtë dhe i bazuar në dispozita ligjore, andaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri për lejimin e përmbarrimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1420/2022 të datës 29.05.2023, me të cilin në pikën I të dispozitivit ka Refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit “Isufi” SH.P.K., me numër të biznesit 71259218, të ushtruar kundër urdhrin përmbarrimor P.nr.359/2021, të lejuar me datë 02.04.2021, nga Përmbarruesi Privat Mehdi Reshani. Në pikën II të dispozitivit urdhrin përmbarrimor P.nr.59/2021, të lejuar me datë 02.04.2021, nga përmbarruesi privat Mehdi Reshani, e ka lënë në fuqi.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për arsye se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin në mbështetje të nenit 21 të LPP-së, se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara

në kuptim të nenit 27 paragrafi 1 dhe 36 paragrafi 1 të LPP-së. Tutje ka arsyetuar se ka vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, mirëpo të njëjtat i ka vlerësuar si të pabazuara në kuptim të dispozitës së nenit 144 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për arsye se dokumenti përmbarimor - Aktvendimi nr.4912, i datës 10.12.2019, ka marr formë të prerë me datë 26.08.2020, dhe është bërë i ekzekutueshëm me datë 11.09.2020, ndërsa propozimi për përmbarim nga ana e kreditorit është paraqitur me datë 02.04.2021, që nënkupton se nuk ka kaluar afati 5 vjeçar i parashkrimit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore Dhomat e Shkallës së Dytë i vlerësojnë edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë Nr.4912 të datës 10.12.2019, i formës së prerë nga data 26.08.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 11.09.2020, për shumën e detyrimit prej 5,974.88 Euro, në këtë rast është dokument përmbarues, kjo përcaktohet me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se: *“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe neni 27 paragraf 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës procedurale dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me rastin e aprovimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit as për shkelje tjera të pretenduara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që në këtë rast gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit nuk ka gjetur se ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së për pjesën refuzuese të prapësimit..

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë

e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike për refuzimin e prapësimit si të pabazuar.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga këto dokumente rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoi përbarimin.

Nga ana e debitorit janë ngritur edhe pretendime tjera të cilat pretendime nuk janë pranuar si të themelta, sepse në procedurën përbarimore gjykata i përmbahet parimit të rigorozitetit formal - juridik që nënkupton se vlerëson vetëm rrethanat nga të cilat varet lejueshmëria e përbarimit dhe shkaqet që mund të përbejnë bazë të mjaftueshme për prapësim, ndërsa nuk lëshohet fare në vlerësimin e veprimeve që i referohen procedurës në të cilën është marr dokumenti përbarimor. Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret aktvendimi i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë Nr.4912 i datës 10.12.2019, i formës së prerë nga data 26.08.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 11.09.2020, është dokument përbarimor dhe i përbarueshëm dhe cilësia e tillë është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën e ekzekutueshmerisë dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Nuk janë pranuar pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se kërkesa e kreditorit është parashkruar, për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate me dispozitën e nenit 144 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, parashihet se: *“Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin”*. Në kuptim të kësaj dispozite gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit, pasi që në këtë çështje juridike përbarimore, përbarimi është lejuar në bazë të aktvendimit Nr.4912 të datës 10.12.2019, i formës së prerë nga data 26.08.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 11.09.2020, ndërsa propozimin për përbarim kreditori e ka parashtruar me datë 02.04.2021, çka do të thotë se nga dita e plotfuqishmerisë së dokumentit përbarues 26.08.2020, e deri në ditën e paraqitjes së propozimit për përbarim me datë 02.04.2021, nuk kanë kaluar 5 vite, andaj rezulton se kërkesa e kreditorit nuk është parashkruar, me çka një pretendim i tillë u refuzua si e pathemeltë

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë

gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1290/2023 me datë 18.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha